



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:050477

Datë: 16.11.2021

Numri i dokumentit: 02401135

PKR.nr.95/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti për Krime të Rënda, ,
rupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët Shaqir Zika- kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarët Mizair Shabani dhe Myfera Hoxha- anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë e kësaj gjykate, në lëndën penale ndaj të akuzuarit Sh. (Sh.) V., nga Gjakova, për shkak të veprës penale, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë- Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP/I.nr.71/2021, të datës 13.07.2021, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit gjyqësor me datë 04.11.2021, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ali Uka , të dëmtuari K. Ll., të akuzuarit Sh. V. si dhe mbrojtësit të tij av.Korab Bokshi, ndera me datën 05.11..2021, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa **me datën 16.11.2021** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

SH. V. nga i ati Sh., e ëma F., e lindur Shl., data e lindjes . . në Gjakovë ku edhe tani J. në Rr.”. . .” nr. . . , i martuar, atë i tre fëmijëve, ka të kryer fakultetin, me profesion doganier, i gjendjes së mesme e ekonomike, nr. personal ID- . . , Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

I. Se me datën 16.03.2021, rreth orës 12:50 minuta, në Gjakovë Rruga “. . .” pikërisht në punëtorin “. . .” me pronar K. Ll., nga Gjakova, ka shkaktuar rrezik të përgjithshëm për njerëz dhe pasurinë e tyre duke rrezikuar jetën e të dëmtuarit K. Ll., si dhe personave tjerë që janë gjendur në vendin e ngjarjes, dhe atë B. R., në atë mënyrë që pasi më parë ka ndodhur një fjalosje e që ka pas të bëjë me bashkëshorten e tij, për një moment i pandehuri largohet nga hapësirat e punëtorisë, shkon tek automjeti i tij i llojit “. . .” ngjyrë hiri me tabela të regjistrimit . . . , hyn në automjet ku nga aty merr revolen e tipit “Smith –wesson” modeli 669, kthehet në lokal dhe kur shkon në drejtim të zyrës ku mendon se ishte i dëmtuari K., tenton ta hap derën por e njëjta ishte e mbyllur me çelës, shtënë një herë në drejtim të zyrës ku ka menduar se ishte i fshehur i dëmtuari K. dhe më pas me të shpejtë largohet nga vendi i ngjarjes në drejtim të panjohur.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së.

II. Pasi më parë ka siguruar e gjerë me dt. 16.03.2021 rreth orës 12:50 minuta pa autorizim ka poseduar armë dhe municion në kundërshtim me nenin 4 parag.1 nënparag.1.1 të Ligjit për Armët të Republikës së Kosovës, të cilat me ligj kategorizohen si armë zjarri të ndaluara, dhe atë 1 (një) revole e markës Smith-Wesson, modeli 669, numër serik të dëmtuar ku mund te lexohet vetëm tri shkronja “TAE dhe 9 (nëntë) fishek te kalibrit 9x19 mm, të cilën e përdor ditën kritike duke shtie një herë në punëtorinë “. . .” në drejtim të zyrës ku mendonte se fshihej i dëmtuari K. Ll..

- Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 parag.1, te KPRK-së.

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 4, 6, 17, 41, 43, 45, 46, 47, par 1, 73 par.1-3, nenit 356 para 1 neni 366 par.1 te KPRK-së, dhe neneve 359 par. 2, 366, 450 te KPPK-se, te akuzuarin e:

G J Y K O N

- **Për diapozitivin I të akuzës**, për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së, i shqiptohet dënimi me burgim ne kohëzgjatje prej pesë (5) muajve.

- **Për dispozitivin II të akuzës**, për veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, me dënim me gjobë në shumë prej tetëqind (800), të cilin dënim duhet ta paguaj në afatin prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Me kërkesën e mbrojtësit të akuzuarit av.Korab Bokshi dhe pëlqimin e të akuzuarit Sh. V., konform nenit 44 të KPRK-së, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) muajve, me kërkesën dhe pëlqimin e te akuzuarës **I zëvendësohet Me Dënim Me Gjobe** ne shume prej katërmijë (4.000) €.

Andaj gjykata konform nenit 76 par.1 dhe 2 nënpar.2.4 të KPRK-së të akuzuarit i shqipton:

DËNIM UNIK ME GJOBË, në shumë prej katërmijë tët qind (4.800) Euro, në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 16.03.2021 e gjerë me datën 11.06.2021, dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 12.06.2021 e gjerë me datën 30.07.2021, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak do ti llogaritet nga njëzet (20) Euro që i bije dymijetëqindetëdhjetë (2.880) Euro ndërsa pjesa e mbetur e **dënitimit me gjobë** në shumë prej 1.920 Euro, i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej dy (2) muajve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk munden të paguajnë dënimin unik me gjobe atëherë të akuzuarit i zëvendësohet dënimin unik me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetegjashtë (96) ditëve, duke llogaritur për çdo dite nga njëzet (20) €.

Ndaj të akuzuarve konfiskohen: 1 (një) revole e markës Smith-Wesson, modeli 669, numër serik të dëmtuar ku mund te lexohet vetëm tri shkronja “TAE dhe 9 (nëntë) fishek te kalibrit 9x19 mm, si objekte të kryerjes së veprave penale.

Urdhërohet Stacioni Policor në Gjakovë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e armëve dhe municionet të konfiskuar, që në polici evidentohen sipas numrit të rastit 2021-EA-369.

Detyrohet i akuzuari Sh. V. që në emër të paushallit gjyqësorë shumë prej pesëdhjetë (50) Euro, dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

I dëmtuari: K. Ll. nga Gjakova, nuk ka parashtruar kërkesë pasurore-juridike.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, pranë kësaj gjykate, ka ngritur aktakuzën me numër PP/L.nr.71/2021, të datës 13.07.2021, ndaj të akzuarit Sh. (Sh.)V. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar me datën 30.07.2021, në të cilën seancë kanë marr pjesë Prokurori i shtetit Ali Uka, i dëmtuari K. Ll., i akuzuari Sh. V. dhe mbrojtësi i tij av.Korab Bokshi, nga Gjakova, sipas autorizimit në lëndë.

I akuzuari Sh. V., gjatë shqyrtimit fillestar është deklaruar i pafajshëm për veprën penale në dispozitivin I të akuzës, ndërsa për veprën penale nga dispozitivi II i akuzës, ka pranuar fajësinë.

Pasi që aktakuza është konfirmuar gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesorë me datat 07.10.2021, si dhe me datë 04.11.2021, ku ka prezantuar përfaqësuesi i akuzës prokurori i shtetit Ali Uka,i dëmtuari K. Ll., i akuzuari Sh. V., dhe mbrojtësi i tij av. Korab Bokshi.

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimeve gjyqësore dhe procedimit të dëshmitarëve dhe leximit të provave materiale, përfaqësuesi i akuzës prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor verbale publike në çështjen penale kundër të akzuarit Sh. B. nga Gjakova, i akuzuar për veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe atë pas administrimit të gjitha provave si atyre materiale të njëjtat të propozuara në aktakuzë, po ashtu nga provat formale siç është dëshmia e të dëmtuarit K. Ll., dëshmitë e dëshmitarëve V. H.dhe E. T., shikimit në video incizimin e kamerave të sigurisë të nxjerra nga vendi i ngjarjes, u arrit të provohet një gjendje tjetër faktike dhe atë në rastin në fjalë kemi të bëjmë me veprën penale të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së, ashtu që si rrjedhojë e këtij ri cilësimi të kësaj vepre penale bëjë dhe ndryshimin dhe plotësimin e dispozitivit I të akuzës.

Pas ri cilësimit të veprës penale nga ana e prokurorit të shtetit, të akzuarit dhe mbrojtësit të tij i është dhënë kohë e mjaftueshme për konsultim dhe të akzuarit i është dhënë mundësia që tani të deklarohet për pranimin e fajësisë, pas ri cilësimit të veprës penale nga ana e prokurorit të shtetit.

Me këtë raste gjykata e ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 326 të KPP-së, kështu që pas konsultimeve të mjaftueshme të të akuzuarit me mbrojtësin e tij i njëjti ka deklaruar se është plotësisht i vetëdijshëm për rëndësinë e pranimit të fajësisë dhe ka shtuar se ky deklarim paraqet shprehje të vullnetit të tij të lirë, pasi që është kryes i kësaj vepre penale tani të ri cilësuar në fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit andaj në tërësi e pranon fajësinë sipas pikave të aktakuzës dhe se ky pranim i fajësisë mbështetet në provat të cilat i janë ofruar gjykatës në aktakuzë dhe atë nga dëshmia e të dëmtuarit K. Ll., dëshmitarëve B.R., V. H.dhe E. T., si dhe nga provat materiale siç është raporti fillestar i incidentit me numër 2021-EA-369 të datës 16.03.2021, raporti i oficerit D. P., i datës 16.03.2021, raporti i hetuesit E. J.i datës 16.03.2021, raporti i shpejtë me numër 2021-EA-369 i datës 16.03.2021, raporti i hetuesit J. Gj., i datës 16.03.2021, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, fotoalbumi nga vendi i ngjarjes, raporti i bastisjes i datës 18.03.2021, foto albumi i datës 18.03.2021, si dhe shikimi i CD-jave nga vendi i ngjarjes në kamerat e sigurisë dhe atë nga ora 12:46 minuta e 08 sekonda e deri në 12:49 dhe 10 sekonda si dhe nga raporti i ekzaminimit nga AKF/2021-0795/2021-742 i datës 25.05.2021.

Pas deklarimit të akuzuarit për pranimin e fajësisë trupi gjykues kërkoj që mendimin e vetë të jep prokurori i shtetit.

Prokurori i shtetit Ali Uka, duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se e mbështet pranimin e fajësisë nga ana e këtu të akuzuarit Sh. V. dhe atë për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, meqenëse gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor në tërësi u provua se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të ri cilësuar në fjalën përfundimtare në këtë shqyrtim gjyqësor, dhe se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyre vullnetare pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, dhe se aktakuza mbështetet në provat e propozuara në aktakuzë, andaj i propozoi trupit gjykues që ta aprovoi pranimin e fajësisë të bërë këtu nga i akuzuari në këtë fazë të procedurës penale.

I dëmtuari K. Ll., pas deklarimit të akuzuarit për pranimin e fajësisë ka deklaruar se edhe unë si palë e dëmtuar pajtohem me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, në këtë seancë të shqyrtimit gjyqësor dhe deklaroj se ndaj të njëjtit nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe nuk parashtroi kërkesë pasurore-juridike, me të njëjtin jemi pajtuar sipas traditave tona.

Mbrojtësja e të akuzuarit Sh. V., av. Korab Bokshi, duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se në këtë fazë të procedurës penale në seancën e shqyrtimit gjyqësor pas administrimit të të gjitha provave materiale dhe personale me të drejtë prokurori ka vlerësuar se kemi të bëjmë me një gjendje tjetër faktike dhe juridike dhe pas konsultimeve me të mbrojturin tim, të njëjtit i kam shpjeguar për të gjitha favorët dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i propozoi trupit gjykues që ta aprovoi pranimin e fajësisë.

Pas deklarimit të akuzuarit marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit, palës së dëmtuar, mbrojtësit të të akuzuarit, trupi gjykues ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprat penale për të cilat ngarkohet me aktakuzë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së, Gjatë pranimit të fajësisë trupi gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve

të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av.Korab Bokshi, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se në tërësi ngelë pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të ri cilësuar në këtë seancë të shqyrtimit gjyqësor, dhe i propozon trupit gjykues që i akuzuari të shpallet fajtorë për veprat penale, i njëjti të gjykohet sipas ligjit dhe kërkoj nga gjykata që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata të merr për bazë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, me palën e dëmtuar janë pajtuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh. V. av. Korab Bokshi, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se meqë në këtë fazë të shqyrtimit gjyqësor pas administrimit të të gjitha provave dhe ri cilësimit juridik të veprës i mbrojturi imë ka pranuar fajësinë sipas pikave të aktakuzës, e lusim gjykatën që gjatë shqiptimit të sanksionit penale të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese si dhe rrethanat posaçërisht lehtësuese dhe janë plotësuar kushtet ligjore që të aplikohen dispozitat e zbutjes së dënimit përkatësisht ti shqiptohet një dënim nën minimumin e paraparë ligjorë, e me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, me palën e dëmtuar janë pajtuar, i mbrojturi imë është mbajtës i vetëm i familjes, i ati i tre fëmijëve, më herët kurrë nuk ka qenë i gjykuar.

I akuzuari Sh. B., në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, ka shprehur keqardhje për rastin që i ka ndodhur dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale.

2. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata i ka marrë për bazë disa rrethana lehtësuese dhe disa rrethana posaçërisht lehtësuese. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është mbajtës i vetëm i familjes, i ati i tre fëmijëve, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të këtilla nuk do të kryej vepra penale si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor për veprat penale për të cilat ngarkohet, pendimin e tij duke shpreh keqardhje për rastin e ndodhur dhe duke i kërkuar edhe publikisht falje palës së dëmtuar për rastin e ndodhur, i dëmtuari nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk ka parashtruar kërkesën pasurore-juridike. Kështu që duke mos gjetur asnjë rrethanë rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.3 të KPRK-së dhe në rastin konkret ka aplikuar dispozitën e nenit 72 par.1 nënpar.1.6 të KPRK-së kur ka shqiptuar dënimin me burgim nën kufijtë e përcaktuar me ligj si në dispozitiv të aktgjykimit për veprën penale nga neni 356 par.1 të KPRK-së për të akuzuarin dhe ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së. Sipas bindjes së gjykatës dënimet e tilla të shqiptuara janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimet e shqiptuar do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjnë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehin gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

3. Vendimi mbi konfiskimin e armëve

Duke u bazuar në nenin 366 paragrafi 3 të KPRK si dhe në nenin 282 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.1 të KPP-së, kryetari i trupit gjykues ka vendosur që të konfiskohen arma dhe karikatorit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi si objekt i veprës penale.

4. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenet 451 paragrafi 1 dhe 453 të KPP-së dhe konform nenit 39 paragrafi.3 nënparagrafi.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, kryetari i trupit gjykues ka vendosur që i akuzuari t'i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

5. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike

Gjykata të dëmtuarin K. Ll., nuk e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike ngesë i njëjti gjatë shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk parashtroi kërkesë pasurore-juridike dhe nuk kërkojë kompensim dëmi ndaj të akuzuarit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti për Krime të Rënda -
PKR.nr.95/21, me datë 16.11.2021

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Kryetari i trupit gjykues,
Shaqir Zika

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.